



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

## KURRKULA BËRTHAMË

Lënda: Gjuhë shqipe

Shkalla: VI

Klasa: XII

Tiranë, 2017



## TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	2
1. HYRJE.....	3
2. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT TË GJUHËS SHQIPE .....	5
2.1. Qëllimet e arsimit parauniversitar .....	6
2.2. Qëllimet e lëndës së gjuhës shqipe.....	7
2.3. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës.....	7
2.4. Rezultatet kryesore të të nxënit, sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjuhës shqipe gjatë shkallës së pestë dhe shkallës së gjashtë.....	9
2.5. Lidhja e gjuhës shqipe me temat ndërkurrikulare .....	15
3. LIDHJA E GJUHËS SHQIPE ME FUSHAT E TJERA TË TË NXËNIT .....	16
4. KOMPETENCAT E LËNDËS DHE PËRSHKRIMI I TYRE .....	18
5. NDARJA E KOHËS MËSIMORE PËR SECILËN KLASË.....	21
6. PËRMBAJTJA E SHKALLËS SË GJASHTË .....	23
6.1. Klasa XII .....	23
7. SQARIME PËR LLOJET E TEKSTEVE .....	38
8. UDHËZIME METODOLOGJIKE .....	39
9. VLERËSIMI.....	42

## 1. HYRJE

Lënda e gjuhës shqipe bën pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Në arsimin e mesëm të lartë, kjo fushë përbëhet nga lëndët: Gjuhë shqipe, Letërsi, Letërsi me zgjedhje (klasa XII), Gjuhë e huaj e parë dhe Gjuhë e huaj e dytë. Të gjitha lëndët e kësaj fushe synojnë zhvillimin gjuhësor e letrar që është boshti themelor për rritjen intelektuale, shoqërore, estetike dhe emocionale të nxënësve. Më konkretisht, fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i aftëson nxënësit që ta përdorin gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale, për kënaqësi estetike, për të marrë informacion, si dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës.

Lënda e gjuhës shqipe ka një rëndësi të veçantë në kurrikulën e arsimit të mesëm të lartë. Nëpërmjet kësaj lënde, nxënësit:

- fitojnë njohuri dhe demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime rreth sistemit gjuhësor të shqipes;
- fitojnë njohuri dhe demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime për të komunikuar në mënyrën e duhur (të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit).

Lënda e gjuhës shqipe, gjithashtu, siguron mundësi që nxënësit të ndiejnë fuqinë e gjuhës si një mënyrë për të shprehur përvojat e tyre dhe për të shmangur vështirësitë që ndajnë individët. Nxënësit, gjatë zhvillimit të kësaj lënde, ndërtojnë dhe zhvillojnë kompetencat gjuhësore, në mënyrë që të bëhen anëtarë kritikë dhe aktivë në shoqëri. Duke u mbështetur në studimin e teksteve të llojeve dhe tematikave të ndryshme, programi nxit vlerësimin e trashëgimisë së pasur kulturore dhe letrare. Nëpërmjet këtyre teksteve, nxënësit dallojnë dhe vlerësojnë jo vetëm strukturën dhe karakteristikat e vetë teksteve, por edhe mesazhet dhe kuptimet e tyre.

Gjuha shqipe, si çdo lëndë tjetër, mundëson zotërimin e kompetencave kyçe, të përcaktuara në kornizën kurrikulare. Këto kompetenca janë të domosdoshme për një individ, i cili duhet të përmbushë me sukses kërkesat personale, shoqërore dhe profesionale. Këtë “mision” lënda e realizon nëpërmjet ndërtimit dhe zhvillimit të kompetencave të saj. Duke u bazuar në synimet dhe specifikat e lëndës, pesë kompetencat e saj janë:

- Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar.
- Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme.
- Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.
- Të lexuarit e teksteve të ndryshme
- Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit.

Puna për ndërtimin e kompetencave kyçe dhe të kompetencave lëndore ka nisur që në arsimin bazë. Në këtë cikël arsimit, nxënësit janë pajisur me njohuritë, shkathhtësitë, vlerat dhe qëndrimet e domosdoshme për jetën dhe për tregun e punës. Mirëpo kompetenca zhvillohet dhe përsoset gjatë gjithë jetës dhe nuk ka pikëmbërritje. Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit përballen me sfida të reja. P.sh., nga kontekste familjare dhe informale (me shokët e shoqet e klasës dhe me mësuesit), nxënësit tani do të flasin e do të diskutojnë në kontekste më formale (në një debat në shkollë, në aktivitete me mësues, në veprimtari të ndryshme) dhe do të ushtrohen edhe për të folurit në publik.

Programi i gjuhës shqipe bazohet në parimin e integritit të njohurive dhe në parimin e rimarrjes së tyre, vit pas viti, duke i zgjeruar dhe duke i thelluar ato.

## 2. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT TË GJUHËS SHQIPE

Hartimi i programit lëndor mbështetet në dokumentet kryesore kurrikulare: korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i gjimnazit.

Përdoruesit e programit janë mësuesit, autorët e teksteve, prindërit dhe komuniteti, specialistët e arsimit dhe fakultetet e mësuesisë.

**Mësuesit** do ta përdorin programin e gjuhës shqipe për të krijuar një tablo të qartë rreth asaj se çfarë duhet të dinë dhe të jenë të aftë të bëjnë nxënësit dhe se si duhet ta ndërtojnë mësimdhënien për të pajisur nxënësit me kompetencat kyçe dhe të lëndës, si dhe për të përmbushur kërkesat e programit.

**Autorët e teksteve** do ta përdorin programin e gjuhës shqipe për të hartuar tekste shkollore në funksion të realizimit të tij. Leximi i kujdesshëm i programit për çdo shkallë dhe për çdo klasë do t'i ndihmojë ata për të siguruar lidhjen logjike dhe për të shmangur mbingarkesën.

**Prindërit dhe komuniteti**, nëpërmjet programit, mund të informohen për njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet që duhet të zotërojnë fëmijët e tyre në lëndën e gjuhës shqipe.

**Specialistët e arsimit** mund ta përdorin programin e gjuhës shqipe për qëllime inspektimi, monitorimi, vlerësimi, studimi etj.


**Fakultetet e mësuesisë** mund ta përdorin programin lëndor për të përshtatur kurrikulat e tyre, me qëllim përgatitjen efektive të mësuesve të ardhshëm, si dhe për praktikën pedagogjike të studentëve.

Programi i gjuhës shqipe ka në fokus realizimin e kompetencave kyçe dhe të kompetencave të lëndës, gjatë punës për përmbushjen e të cilave do të realizohen temat ndërkurrikulare, të cilat mundësojnë lidhjen e lëndës me jetën e përditshme, me shoqërinë dhe me tregun e punës.

Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e gjuhës shqipe me fushat dhe lëndët e tjera, në mënyrë që formimi i nxënësit të jetë tërësor e jo fragmentar.

Në program janë përcaktuar njohuritë, aftësitë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për çdo kompetencë të lëndës, të klasifikuara sipas disa tematikave. Po kështu, në program janë dhënë sugjerime edhe për shpërndarjen e orëve mësimore.

Diagrami i mëposhtëm paraqet organizimin e programit.



## 2.1. Qëllimet e arsimit parauniversitar

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësit: të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojnë në ndërtimin dhe në mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare, si dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar, nxënësit:

- kultivojnë identitetin vetjak e kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës;

- zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes;
- përdorin teknologjitë e reja.

## 2.2. Qëllimet e lëndës së gjuhës shqipe

Në lëndën e gjuhës shqipe, nxënësit:

- përforcojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre për gjuhën dhe për komunikimin;
- pasurojnë fjalorin e tyre, fitojnë njohuri gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit, si dhe zbatojnë rregullat e gjuhës së folur dhe të shkruar;
- shkruajnë qartë, saktë e në mënyrë logjike dhe përshtatin gjuhën dhe stilin e tyre në varësi të qëllimit, kontekstit dhe audiencës;
- krijojnë marrëdhënie të qëndrueshme me leximin, nëpërmjet të cilit fitojnë kënaqësi dhe informacion;
- përdorin diskutimin dhe ndërveprojnë me të tjerët, me qëllim që të komunikojnë, të mësojnë të shprehin qartë dhe të argumentojnë mendimet dhe idetë e tyre;
- zotërojnë “artin” e të folurit dhe të dëgjuarit, bëjnë prezantime formale dhe marrin pjesë në diskutime dhe në debate të ndryshme duke dhënë kontributin e tyre;
- përvetësojnë aftësitë e duhura për të analizuar, për të interpretuar, për të vlerësuar dhe për të prodhuar tekste për një larmi funksionesh;
- zbatojnë njohuritë dhe strategjitë e procesit të të lexuarit për t’u bërë lexues të pavarur, si dhe për të kuptuar dhe për të gjykuar tekste dhe materiale të llojeve të ndryshme;
- interpretojnë dhe vlerësojnë informacione të ndryshme për botën në përgjithësi.

## 2.3. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës

Një nga synimet kryesore të arsimit është që të krijojë qytetarë që janë të aftë të bëjnë gjëra të reja, që janë krijuar dhe zbulues. Arsimi, gjithashtu, formon dhe zhvillon mendje kritike të cilat gjykojnë, verifikojnë dhe nuk pranojnë çdo gjë që u jepet. Për t’i përgatitur këta qytetarë, në kornizën kurrikulare janë përcaktuar kompetencat kyçe, si të domosdoshme për një individ, me qëllim që ai të jetë i suksesshëm në jetën personale, shoqërore dhe profesionale. Këto kompetenca duhen ndërtuar dhe duhen zhvilluar gjatë gjithë procesit mësimor.

Realizimi i kompetencave kyçe gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënies kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat e lëndës me kompetencat kyçe për secilën shkallë. Për ta realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të të nxënies.


përmbush kompetencat e lëndës së gjuhës shqipe, ai, njëkohësisht, zhvillon edhe kompetencat kyçe. P.sh., gjatë një prezantimi, nxënësi përdor edhe mjetet e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit dhe zhvillon, kështu, edhe kompetencën digjitale. Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe në këndvështrimin e domosdoshmërisë së tyre në jetë, në shoqëri dhe në punë.

Më konkretisht, për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës, mësuesi ndjek këta hapa:

- përzgjedh rezultatin/rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- përcakton rezultatin e të nxënit të kompetencave kyçe për vit mësimor duke zbërthyer rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe për shkallë mësimore (janë përcaktuar në program);
- përzgjedh përmbajtjen/përmbajtjet mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit mësimor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave e projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe për shkallë për lëndën e gjuhës shqipe.



Diagrami i mëposhtëm konkretizon lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës.



#### 2.4. Rezultatet kryesore të të nxënit, sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjuhës shqipe gjatë shkallës së pestë dhe shkallës së gjashtë

Në kurrikulën bërthamë janë përcaktuar rezultatet e të nxënit për çdo kompetencë kyçe. Këto rezultate realizohen nëpërmjet fushave të të nxënit dhe lëndëve mësimore. Natyrisht, secila fushë dhe lëndë mund të kontribuojë në disa rezultate të nxëni. Fusha “Gjuhët dhe komunikimi”, ku bën pjesë edhe lënda e gjuhës shqipe, ndihmon realizimin e të gjitha kompetencave, por, më së shumti, të kompetencës së komunikimit dhe të të shprehurit. Tabela e mëposhtme paraqet rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjuhës shqipe gjatë shkallës së pestë dhe shkallës së gjashtë.

Shkalla V	Shkalla VI
<b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b> <i>Nxënësi komunikon në mënyrë efektive.</i>	
<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shprehet, përmes një forme komunikimi, për një temë të caktuar në një material (paraqitje) prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore të ngritura në atë material;</li> <li>- diskuton në grup, në mënyrë konstruktive, në kohëzgjatje jo më shumë se 10 minuta, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar nga fushat e të nxënësit ose nga jeta e përditshme;</li> <li>- lexon rrjedhshëm një tekst të përbërë prej 3-5 paragrafë, u përgjigjet pyetjeve të shtruar për llojin e tekstit dhe stilet e të shkruarit, tregon qëllimin dhe lidhjen ndërmjet përmbajtjes së paragrafëve;</li> <li>- përdor drejt strukturën dhe rregullat e drejtshkrimit të gjuhës në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, e-mail (postë elektronike), letër formale dhe joformale etj.;</li> <li>- shkruan një tekst për një temë nga jeta e përditshme, me 3-5 paragrafë, duke respektuar strukturën, drejtshkrimin dhe elementet e tjera, pastaj e prezanton para të tjerëve me shqiptim të drejtë;</li> <li>- paraqet një projekt (artistik, humanitar, eksperimentues etj.) nga fusha të ndryshme mësimore, të hartuar individualisht dhe në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive, teknologjinë e informacionit dhe teknologji të tjera;</li> <li>- përdor TIK-un në mënyrë efektive gjatë komunikimit dhe ndërveprimit me të tjerët në jetën e përditshme, duke përfshirë edhe të nxënësit e informacioneve të reja dhe kryerjen e detyrave shkollore.</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shpreh, para një audience të caktuar mësimore, çështjet kryesore të ngritura në një fjalim ose interpretim të dëgjuar për një temë të caktuar nga fusha të ndryshme, përmes, së paku, një forme të komunikimit (gjuhës, simboleve, shenjave, kodeve, performancës artistike) etj.;</li> <li>- diskuton në grup, në mënyrë konstruktive, duke dhënë informacion e argumente dhe duke shtruar pyetje në diskutim për një temë të caktuar;</li> <li>- përdor drejt strukturën dhe rregullat e drejtshkrimit të gjuhës amtare dhe të gjuhës së huaj në një numër të caktuar të konteksteve, si: ese, e-mail, letër formale dhe joformale etj.;</li> <li>- lexon rrjedhshëm një tekst të përbërë prej disa paragrafësh dhe shprehet në forma të ndryshme të komunikimit për organizimin, qëllimin e leksikun e përdorur dhe argumenton mesazhin që mbart secili paragraf (teksti mund të jetë rrëfyes, përshkrues etj.);</li> <li>- paraqet një temë të caktuar nga arti, nga shkenca, nga jeta e përditshme dhe, në mënyrë efektive, komunikon me audiencën, duke përdorur TIK-un dhe mediat e tjera të shkruara dhe elektronike;</li> <li>- shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin e tij për një temë të caktuar nga jeta, shkenca, profesioni, shoqëria, mjedisi, duke përdorur forma të ndryshme të komunikimit me gojë e me shkrim, të artit pamor, muzikor, skenik, krijimin letrar etj.;</li> <li>- angazhohet dhe kontribuon në një diskutim me të tjerët për një temë të caktuar, si p.sh., për edukimin mediatik, duke paraqitur argumente të bazuara në fakte për rolin dhe</li> </ul>

	<p>ndikimin e televizionit, radios, shtypit dhe mjeteve të tjera të informacionit në shoqëri, në procesin e përgatitjes së të rinjve për jetë të pavarur dhe orientim në karrierë;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përdor, në mënyrë efektive, programet e TIK-ut gjatë procesit të të nxënësimit (duke përfshirë edhe të nxënësimit në distancë) dhe gjatë kryerjes së detyrave në një fushë mësimore të caktuar.</li> </ul>
--	--

### Kompetenca e të menduarit

#### *Nxënësi mendon në mënyrë krijuese.*

<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- paraqet, në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh.: temë nga shkenca, kultura, arti, sporti, shëndetësia, shoqëria, mjedisi etj.);</li> <li>- krahason, të paktën, tri burime të ndryshme të informacionit për trajtimin e temës së njëjtë, argumenton saktësinë e rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur TIK-un;</li> <li>- modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë ose jashtë saj) për një temë të caktuar nga një fushë mësimore, duke e zbërthyer në hapa të vegjël, dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon, në mënyrë të pavarur, informacionet e marra nga burimet e ndryshme për një temë ose detyrë të dhënë, vlerëson cilësinë e tyre dhe i radhit ato sipas rëndësisë dhe sipas qëllimit që kanë;</li> <li>- hulumton, në mënyrë të pavarur, për një çështje të caktuar, duke përcaktuar fazat dhe procedurat e hulumtimit, paraqet dhe interpreton rezultatet e fituara në tabela dhe grafikë, duke përdorur teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit;</li> <li>- identifikon burimet e informacioneve të nevojshme dhe i shfrytëzon ato në mënyrën e duhur për të zgjidhur një problem, duke dhënë shembuj konkretë.</li> </ul>
--	---

### Kompetenca e të nxënësimit

#### *Nxënësi mëson për të nxënë.*

<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në matematikë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënësimit të dijeve të</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- demonstroi shkathtësi të përdorimit të TIK-ut në situata të përditshme dhe në përmbushjen e kërkesave të ndryshme gjatë të nxënësimit (p.sh.: për ndërtimin e tabelave, grafikëve apo diagrameve, për</li> </ul>
--	--

<p>reja në ndonjë fushë të caktuar mësimore;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shfrytëzon në mënyrë efektive përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjes së ndonjë detyre ose aktiviteti në ndonjë fushë të caktuar mësimore;</li> <li>- përgatit me sukses një përmbledhje të dosjes personale (portofolit), për vetëvlerësimin e përparimit të vet në një fushë mësimore të caktuar, veçon, në fund të përmbledhjes, disa çështje që vërtetojnë përparimin e vet dhe disa nevoja të domosdoshme për përmirësimin e avancimit të mëtejshëm;</li> <li>- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur dhe efektive, teknologjinë e informacionit dhe burime të tjera informacioni për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes;</li> <li>- kërkon dhe shfrytëzon në mënyrën e duhur këshilla dhe informacione për kapërcimin e vështirësive në të nxënë në një fushë të caktuar dhe, më pas, prezanton rezultatet e arritura;</li> <li>- paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritshme (në formë skice, grafiku, vizatimi, shkrimi, veprë artistike etj.);</li> <li>- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna në ndonjë burim informacioni për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë, ose për të zgjidhur një problem që kërkohet prej tij, vlerëson vetë performancën dhe rezultatin e arritur, duke iu referuar qëllimeve fillestare (p.sh.: burime informacioni në libër, revistë, enciklopedi, internet, hartë, grafik, skicë, partiturë muzikore, skenar etj.).</li> </ul>	<p>vizatimin e një plani të shtëpisë, apo për përgatitjen e shkresave dhe prezantimeve etj.);</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- diskuton në grup për mënyrat e bashkëpunimit me të tjerët për të zgjidhur një situatë të re mësimore, tregon mënyrën e shfrytëzimit të përvojave paraprake për të zhvilluar njohuritë dhe shkathtësitë e reja në zgjidhjen e situatave dhe problemeve të tilla;</li> <li>- shfrytëzon në mënyrën e duhur këshillat dhe informacionet e marra për përkrahje në zgjidhjen e një detyre apo problemi të caktuar, pastaj rezultatet i paraqet para të tjerëve;</li> <li>- përpunon, në mënyrë të pavarur dhe efektive, informacionet për një temë të caktuar dhe rezultatet e punës i prezanton me shkrim ose me gojë para të tjerëve, duke dhënë shpjegime për mënyrën e zgjedhjes dhe të shfrytëzimit të burimeve të informacionit.</li> <li>- paraqet një plan studimi (në formë skice, vizatimi, shkrimi etj.) për ndonjë çështje të caktuar (p.sh.: vlerat kulturore të rajonit të vet, vlerat e edukimit në shoqëri etj.) duke respektuar të gjithë hapat e planit të studimit dhe e paraqet atë para të tjerëve;</li> <li>- përzgjedh punimet kryesore të dosjes së vet për të shpjeguar para një audience të caktuar strategjitë që ka zbatuar për të ndjekur avancimin e vet dhe masat që ka marrë për të përmirësuar përparimin në mënyrë të vazhdueshme;</li> <li>- vlerëson, në mënyrë kritike, punën e vet duke iu referuar qëllimeve fillestare të punës, p.sh., në mënyrë të pavarur redakton një dorëshkrim të tij për përmirësimin e organizimit të shkrimit, qartësisë së mendimit etj.;</li> <li>- menaxhon në mënyrë produktive burimet që i ka në dispozicion (kohën, njerëzit, mjetet e konkretizimit/punës etj.) gjatë kryerjes së një aktiviteti ose detyre të</li> </ul>
--	--

	caktuar në një fushë mësimore apo në situata të jetës së përditshme.
<b>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</b> <i>Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive.</i>	
<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- harton një projekt me faza të mirëmenaxhuara (individualisht ose në grup) duke shkëmbyer ide, duke u konsultuar me të tjerët dhe duke i informuar ata, si dhe duke identifikuar dhe vlerësuar burimet njerëzore, materiale dhe monetare në përputhje me rezultatet e pritshme;</li> <li>- merr pjesë në veprimtari të ndryshme në nivel klase, shkolle, bashkie dhe më gjerë (p.sh.: konkurse mësimore, gara sportive, aktivitete kulturore, muzikore etj.), diskuton me të tjerët për rezultatet e arritura dhe për procesin e organizimit dhe jep argumente në forma të ndryshme shprehëse si të rritet pjesëmarrja në veprimtari dhe si të përmirësohet procesi i organizimit të tyre.</li> </ul>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- paraqet, nëpërmjet njërës prej formave të shprehjes, kompetencat e nevojshme për të përballuar situata të ndryshme jetësore apo për zhvillimin e karrierës në një fushë të caktuar;</li> <li>- ndërmerr nisma të suksesshme për organizimin e veprimtarive të ndryshme që nxisin bashkëpunimin e ndërmarrjeve me komunitetin, duke promovuar interesin e dyanshëm.</li> </ul>
<b>Kompetenca personale</b> <i>Nxënësi bën jetë të shëndetshme.</i>	
<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon përparësitë dhe dobësitë vetjake duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal, në përparësitë që ka dhe masat përmes të cilave synon të përmirësojë dobësitë personale;</li> <li>- merr pjesë aktivisht në lojëra, në gara sportive dhe në veprimtari të tjera kulturore dhe, në mënyrë konstruktive, menaxhon emocionet e veta;</li> <li>- ilustron, me shembuj para të tjerëve, modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.</li> </ul>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- tregon shkathtësi në organizimin e lojërave me të tjerët, të garave sportive apo veprimtarive kulturore, dhe menaxhon me sukses emocionet e veta në situata të ndryshme gjatë aktiviteteve dhe gjatë jetës së përditshme;</li> <li>- paraqet, në forma të ndryshme shprehëse, mënyrën e zbatimit të planeve personale të jetës (p.sh.: në shkollim, në karrierë, në sport, në shoqëri, në biznes etj.), vlerëson nivelin e arritjes së qëllimeve të synuara dhe ilustron shembuj të veçantë të planeve personale për të ardhmen.</li> </ul>
<b>Kompetenca qytetare</b>	

*Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.*

**Nxënësi:**

- demonstroi shembuj të pjesëmarrjes demokratike dhe drejton forma të ndryshme të diskutimit për përfshirjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes demokratike në nivele të ndryshme (në familje, në shkollë, në komunitet, në nivel vendor dhe qendror), gjatë diskutimit tregon tolerancë dhe respekt për pyetjet dhe komentet e të tjerëve;
- demonstroi veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët;
- diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj. dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.

**Nxënësi:**

- paraqet, në forma të ndryshme, se si i ushtron të drejtat e veta në shkollë dhe në jetën e përditshme dhe si i njeh e i respekton të drejtat e të tjerëve, duke dhënë shembuj konkretë;
- paraqet, në forma të ndryshme të shprehurit, vlerat kryesore të shumëllojshmërisë në shoqëri apo në mjedisin ku jeton, i diskuton ato me të tjerët, duke i krahasuar me shembuj nga jeta e përditshme që tregojnë tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve;
- merr pjesë në proceset demokratike të vendimmarrjes në nivele të ndryshme (në familje, shkollë, komunitet etj.), i diskuton me të tjerët përvojat personale dhe paraqet propozime të argumentuara se si të përmirësohet pjesëmarrja demokratike dhe vendimmarrja në shoqëri.

**Kompetenca digjitale**

*Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.*

**Nxënësi:**

- përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative, duke përfshirë edhe komunikimet në distancë, për zhvillimin e njohurive;
- përdor mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore nëpërmjet pamjeve të filmuara apo të animuara;
- gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash;
- zhvillon aftësitë krijuese, duke zbatuar njohuritë e marra në shkencën kompjuterike dhe mediat digjitale.

**Nxënësi:**

- përdor, në mënyrë efektive, programet e TIK-ut për të komunikuar dhe për të bashkëpunuar me bashkëmoshatarët gjatë procesit të të nxënimit, duke përfshirë edhe të nxënimit në distancë;
- vlerëson cilësinë e informacionit të gjetur nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash;
- është aktiv dhe i pavarur në procesin e të nxënimit për gjetjen dhe përdorimin e metodologjive që lehtësojnë këtë proces.



## 2.5. Lidhja e gjuhës shqipe me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare integrojnë fushat e të nxënit dhe i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë e të interpretojnë botën dhe të lidhin dijet e marra në shkollë me jetën dhe me interesat e tyre. Në kornizën kurrikulare janë përcaktuar temat ndërkurrikulare të mëposhtme:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Të drejtat e njeriut.
- Vendimmarrja morale.
- Bashkëjetesa paqësore.

Mësimi i gjuhës shqipe, për specifikat dhe hapësirat që ka, lejon krijimin e situatave mësimore që mundësojnë trajtimin e këtyre temave. Kështu, p.sh., leximi dhe studimi i teksteve të ndryshme zhvillojnë te nxënësit identitetin kombëtar dhe njohjen e vlerësimin e kulturës botërore. Tema, si të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale, mjedisi, zhvillimi i qëndrueshëm etj., mund të realizohen gjatë diskutimeve dhe bashkëbisedimeve në grup që zhvillohen gjatë orëve mësimore. Mësuesi mund të krijojë edhe situata mësimore, gjatë të cilave nxënësit shprehen në forma të ndryshme: ese dhe shkrime e krijime të tjera me tematikë rreth çështjeve të mësipërme. Punët në grupe që zhvillohen në lëndën e gjuhës e shqipe, ndihmojnë aftësimin e nxënësve për të jetuar në mënyrë paqësore me të tjerët.

### 3. LIDHJA E GJUHËS SHQIPE ME FUSHAT E TJERA TË TË NXËNIT

Gjuha shqipe është jo vetëm disiplinë, por edhe gjuhë e procesit të mësimdhënies dhe e të nxënit. Si e tillë, lidhjet e saj me fushat dhe lëndët e tjera mësimore janë të qarta dhe plotësuese. Një nxënës që nuk zotëron mirë kompetencat gjuhësore, ka pak gjasa të ketë arritje në fushat/lëndët e tjera mësimore. Natyrisht, në këtë lidhje ka marrje dhe dhënie.

Në mënyrë të veçantë, lënda e gjuhës shqipe lidhet me lëndët e fushës “Gjuhët dhe komunikimi”. Kështu, letërsia i ofron gjuhës një model të përsosur të përdorimit të gjuhës, ndërsa studimi i gjuhëve të huaja siguron transferimin e njohurive gjuhësore nga një lëndë në një tjetër, por edhe vlerësimin e mundësive shprehëse të gjuhës shqipe.

Lënda e gjuhës shqipe (aftësitë e të lexuarit) mbështet kuptimin e ushtrimeve dhe të teksteve matematikore. Kjo lëndë është e nevojshme për formimin e koncepteve dhe të proceseve matematike. Aftësitë e mira gjuhësore e lejojnë nxënësin të përmirësojë elementet pamore, përfshirë edhe organizimin e grafikëve. Të mësuarit e gjuhës dhe të mësuarit e matematikës janë të ngjashëm në disa pikëpamje: të dyja lëndët përfshijnë situata që u kërkojnë nxënësve të komunikojnë lloje të ndryshme mesazhesh; të dyja lëndët kanë të bëjnë me interpretimin e informacionit, planifikimin, organizimin e ideve dhe përcaktimin e një procedure; të dyja lëndët e ndihmojnë nxënësin të zhvillojë aftësinë për të paraqitur një argument ose një analizë nga këndvështrime të ndryshme; të dyja lëndët përdorin një qasje deduktive.

Kuptimi dhe analiza e teksteve të shkencave të natyrës kërkon aftësi të mira leximi. Po kështu, p.sh., leximi i një teksti i ndihmon nxënësit të marrin njohuri rreth natyrës, siç njohuritë e marra në shkencat e natyrës nxitin imagjinatën për të realizuar me shkrim një përshkrim të natyrës.

Në mënyrë të veçantë, lënda e gjuhës shqipe është e lidhur me historinë dhe me shkencat shoqërore, përderisa të gjitha tekstet që studiohen nga nxënësit, kanë një kontekst historik dhe socio-kulturor.

Mësimi i arteve të ndryshme mbështetet nga lënda e gjuhës shqipe. Kështu, analiza e teksteve të ndryshme me tematikë nga arti ndihmon nxënësit për lëndët e arteve. Gjithashtu, studimi dhe krijimi i teksteve të ndryshme, si p.sh., i reklamave, kërkon integrim me artet për elementet pamore të reklamave etj.

Shembujt e mësipërm janë vetëm një nxitje për të kuptuar se në procesin mësimor krijohen mundësi për integrim mes fushave të të nxënit. Mësuesit, me pasionin dhe përkushtimin që i karakterizon, mund të realizojnë pafund integrimet mes fushave dhe lëndëve në situata të



ndryshme të nxëni. Këto integritime mundësojnë që nxënësit të mos marrin njohuri të fragmentuara dhe të shkëputura nga jeta.

Gjuha shqipe jo vetëm kontribuon, por edhe përdor njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë e fituara në lëndët e tjera. Kështu, në një projekt nxënësit përdorin TIK-un, nxjerrin fakte historike, përpunojnë të dhëna etj. Pra, për të përfunduar me sukses këtë detyrë, nxënësit integrojnë njohuritë e fituara nga fusha/lëndë të ndryshme të dijes (TIK dhe histori).

Në diagramin e mëposhtëm janë pasqyruar disa nga lidhjet mes gjuhës shqipe dhe lëndëve të tjera.



## 4. KOMPETENCAT E LËNDËS DHE PËRSHKRIMI I TYRE

Puna për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave të lëndës nuk është e copëzuar dhe fragmentare. Çdo orë mësimore kontribuon për to. Kompetencat ndërlidhen dhe plotësojnë njëra-tjetrën. Kështu, kompetenca “Të lexuarit e teksteve të ndryshme” (njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e kësaj kompetence) ndikon në aftësimin e nxënësve për të shkruar dhe për të folur, ndërsa formimi i nxënësve rreth sistemit gjuhësor të shqipes ndikon në zhvillimin e kompetencave të tjera.

Më poshtë janë dhënë përshkrimet e kompetencave të lëndës.

### a) Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Të folurit është mjete themelor i komunikimit me të tjerët dhe gur themeli i të mësuarit në të gjitha lëndët mësimore. Duke folur dhe duke biseduar, nxënësit jo vetëm japin informacion, por edhe sqarojnë kuptimin dhe domethënien e koncepteve të ndryshme, identifikojnë dhe zgjidhin probleme, zgjerojnë njohuritë, si dhe shprehin mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tyre. Kur ata diskutojnë rreth një informacioni, njohin dhe pranojnë edhe këndvështrimet e bashkëbiseduesve të tjerë, si dhe mjetet gjuhësore apo stilin që ata përdorin.

Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit përmirësojnë aftësitë e tyre për të komunikuar dhe për të prezantuar ide në klasë dhe në situata formale. Nëpërmjet këtyre situatave, nxënësit aftësohen edhe për të folurit në publik. Ata mësojnë të flasin qartë, bindshëm e me vetëbesim dhe të jenë tërheqës për të tjerët:

- duke përdorur gjuhën standarde, sidomos kur këtë e dikton situata dhe dëgjuesit;
- duke diskutuar në grupe të vogla dhe të mëdha, duke marrë role të ndryshme në menaxhimin dhe në moderimin e diskutimeve dhe debateve, si dhe duke përfshirë e angazhuar të tjerët për të përmbushur afatet dhe qëllimet;
- duke respektuar, gjatë prezantimeve me gojë, karakteristikat e një fjalimi, të një shpjegimi, të një raportimi, të një debati etj.;
- duke përzgjedhur fjalët e fjalitë e përshtatshme dhe duke përdorur mjete retorike e të figurshme;
- duke përdorur dhe duke vlerësuar TIK-un gjatë prezantimeve në aktivitete të ndryshme në shkollë dhe jashtë saj.

### b) Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Gjatë arsimit të mesëm të lartë, nxënësit reflektojnë ndaj informacioneve të llojeve dhe të fushave të ndryshme; përmbledhin, parafrzojnë dhe vlerësojnë përmbajtjen e informacionit të dëgjuar; analizojnë stilin dhe strukturën e një fjalie ose të një teksti të dëgjuar; përqendrohen te folësi, diskutojnë dhe zgjerojnë idetë e dëgjuara; mbajnë shënime të tilla që demonstrojnë të dëgjuarit e qëllimshëm etj.

### **c) Të lexuarit e teksteve të ndryshme**

Edhe pse disa nxënës që hyjnë në klasën e dhjetë, janë lexues të pavarur, shumë prej tyre mund të kenë nevojë për mbështetje, me qëllim që të zhvillojnë më tej aftësitë në lexim. Pra, ky proces duhet të vijojë edhe në arsimin e mesëm të lartë.

Përveç kësaj, të gjithë nxënësit përballen me sfidat që shtron programi i gjuhës shqipe, i cili kërkon nga nxënësit të përvetësojnë koncepte gjithnjë e më abstrakte, të përdorin struktura gjuhësore më komplekse, si dhe të kenë fjalor më të pasur se në arsimin bazë.

Lënda e gjuhës shqipe i ndihmon nxënësit që të lexojnë në mënyrë aktive dhe kritike, si dhe ta përthithin mirë e shpejt informacionin. Një lexues aktiv dhe kritik është ai që jo vetëm i kupton njohuritë që komunikohen në një tekst, por edhe i përdor ato në kontekste të reja. Për ta realizuar këtë, nxënësit zbatojnë një sërë strategjish të të kuptuarit, si dhe njihen me një shumëllojshmëri tekstesh.

Njohja me tekste të ndryshme u jep mundësinë nxënësve që të zbulojnë interesat dhe prirjet e tyre dhe, gjithashtu, ta kenë më të lehtë të zgjedhin orientimin e karrierës së tyre.

### **d) Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale**

Të shkruarit u jep mundësi nxënësve të mësojnë për veten e tyre dhe të lidhen me botën. Një nga qëllimet e programit të gjuhës shqipe është që nxënësit të demonstrojnë siguri dhe saktësi kur shkruajnë, të hulumtojnë para se të shkruajnë një tekst, si dhe të komunikojnë me kompetencë, duke përdorur forma dhe stile të ndryshme të shkruarit.

Gjatë tri viteve, nxënësit krijojnë, organizojnë dhe përzgjedhin ide për të shkruar për qëllime, audienca dhe situata të ndryshme. Ata zbatojnë hapat e domosdoshëm të procesit të shkrimit (planifikimi, organizimi i punës me shkrim, rishikimi, redaktimi etj.). Gjatë të shkruarit, nxënësit zbatojnë karakteristikat e teksteve dhe rregullat gramatikore e drejtshkrimore.

### **e) Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit**

Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit demonstrojnë ndërgjegjësimit dhe saktësi në përdorimin e njohurive rreth sistemit gjuhësor të shqipes. Ata i konsolidojnë njohuritë gjuhësore, aftësohen ta përdorin gjuhën saktë dhe brenda rregullave gramatikore. Nxënësit i përdorin njohuritë gjuhësore për të organizuar, për të redaktuar dhe për të përmirësuar shkrimet e tyre, për të folur qartë dhe saktë, për të gjykuar gjuhën e një teksti që dëgjojnë ose lexojnë etj. Në këtë cikël, nxënësit përcaktojnë dallimet mes gjuhës së folur e gjuhës së shkruar, analizojnë regjistrat e gjuhës, vlerësojnë pasurinë leksikore të gjuhës shqipe dhe zbatojnë rregullat drejtshkrimore dhe ato të pikësimit.

## 5. NDARJA E KOHËS MËSIMORE PËR SECILËN KLASË

Gjuha shqipe zhvillohet përgjatë tri viteve të arsimit të mesëm të lartë. Në tabelën e mëposhtme është dhënë koha mësimore për shkallën e pestë dhe shkallën e gjashtë (klasat X-XII).

Klasa/ shkalla	X	XI	Shkalla V	XII	Shkalla VI
Orë/javë	2	2	4	2	2
Javë mësimore	36	36	72	34	34
<b>Orë gjithsej</b>	<b>72</b>	<b>72</b>	<b>144</b>	<b>68</b>	<b>68</b>

Koha mësimore përdoret:

- për njohuri të reja;
- për përsëritje;
- për testime;
- për ushtrime;
- për punë me shkrim ose ese;
- për vetëvlerësime;
- për projekte kurrikulare etj.

Në lëndën e gjuhës shqipe, gjatë çdo ore mësimi, nxënësit flasin, dëgjojnë, lexojnë, shkruajnë dhe fitojnë njohuri dhe shkathtësi rreth sistemit gjuhësor. Kjo do të thotë që çdo orë mësimi shërben për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave lëndore. Orët e mësimi shërbejnë edhe për zhvillimin e kompetencave kyçe.

**Sugjerime për ndarjen e kohës mësimore sipas klasave**

Ndarjet kryesore	Orë mësimi të sugjeruara	
	Klasat X dhe XI	Klasa XII
Të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit e teksteve të ndryshme (përshkruese, rrëfyese, argumentuese, udhëzuese, informuese-paraqitëse).	40 orë	35 orë

<b>Shënim.</b> <i>Koha mësimore duhet të shpërndahet në mënyrë të barabartë (afërsisht) mes llojeve të teksteve.</i>		
<b>Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit</b>  <b>Shënim.</b> <i>Njohuritë gramatikore, rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit duhet të integrohen me studimin e teksteve përshkruese, rrëfyese, argumentuese, udhëzuese, informuese-paraqitëse.</i>	32 orë	27 orë
<b>Përgatitja e nxënësve për provimet e Maturës Shtetërore</b>  <b>Shënim.</b> Këto orë mund të planifikohen përgjatë vitit shkollor ose në fund të tij.	-	6 orë
<b>Gjithsej:</b>	<b>72 orë</b>	<b>68 orë</b>

## 6. PËRMBAJTJA E SHKALLËS SË GJASHTË



Tekstet ose fragmentet që do të përfshihen në tekstin shkollor të klasës XII sugjerohet të jenë të shkruara nga gjuhëtarët tanë dhe nga albanologë të huaj. Përfshirja e tyre krijon mundësi për integrim lëndor, si p.sh., në një tekst që jep argumente pse shqipja është një degë e familjes indoevropiane, nxënësit mund të studiojnë teknikat e shkrimit dhe karakteristikat gjuhësore e strukturore të tekstit argumentues.

### 6.1. Klasa XII

<b>Kompetenca:</b> Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	
<b>Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë</b> Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"><li>- zgjeron gamën e strategjive për mbledhjen e të dhënave të nevojshme që do të përdorë gjatë prezantimeve;</li><li>- zbaton hapat e përgatitjes dhe të mbajtjes së një fjalimi për tema të ndryshme;</li><li>- për zgjedh fjalët dhe shprehjet e përshtatshme, në mënyrë që të ndikojë te dëgjuesit, si dhe përmirëson zgjedhjen e fjalëve duke përdorur mjete retorike dhe të figurshme;</li><li>- vlerëson rolin e përdorimit të TIK-ut gjatë prezantimeve më gojë dhe analizon funksionet e këtij përdorimi.</li></ul>	
<b>Njohuritë</b>	<b>Shkathtësitë</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Përshtatja e gjuhës gjatë të folurit me qëllimin, temën, dëgjuesin etj.</li><li>- Të folurit për të informuar dhe të folurit për të bindur.</li><li>- Përdorimi dhe përparësitë e mjeteve ndihmëse pamore gjatë një prezantimi (fotografitë, modelet, grafikët, tabelat, videot etj.).</li><li>- Fjalimi bindës.</li></ul> <p><b>Shënim.</b> Gjatë vitit shkollor, nxënësi duhet të realizojë një fjalim argumentues/bindës dhe të vlerësohet për të.</p>	<b>Komunikimi dhe gjuha gjatë të folurit</b> Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"><li>- përshtat gjuhën me qëllimin, temën, dëgjuesin etj.;</li><li>- mbledh, vlerëson, për zgjedh dhe sintetizon fakte dhe ide nga një sërë burimesh;</li><li>- ndan informacionin që mbledh, në informacion të rëndësishëm dhe informacion dytësor;</li></ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- zgjedh format e përshtatshme për të përcjellë informacion, ide dhe pikëpamje për qëllime dhe dëgjues të ndryshëm;</li> <li>- flet rrjedhshëm dhe qartë;</li> <li>- është i vetëdijshëm që kuptimi transmetohet edhe përmes cilësive të zërit, si: ritmi, toni, theksi;</li> <li>- flet me zë të përshtatshëm për dëgjues dhe qëllime të ndryshme;</li> <li>- mbështet idetë dhe pikëpamjet duke integruar edhe elemente të tjera joverbale (p.sh., gjeste, shprehje të fytyrës) për të përcjellë një mesazh;</li> <li>- përgatit dhe përdor mjete ndihmëse pamore gjatë një prezantimi (fotografitë, modelet, grafikët, tabelat, videot etj.);</li> <li>- dallon, analizon dhe përdor të folurit për të informuar dhe të folurit për të bindur;</li> <li>- fokusohet në idenë kryesore në një fjalim;</li> <li>- përdor regjistrin e duhur në kontekste formale dhe joformale;</li> <li>- thekson pikat kyçe për t'i orientuar dëgjuesit në ndjekjen e ideve të rëndësishme;</li> <li>- qartëson dhe sqaron çështjet, idetë ose argumentet duke përdorur detaje, shembuj, përvoja, ndjesi etj.;</li> <li>- përdor gjuhën standarde dhe një fjalor të pasur (krahasime, metafora, fjalë të urta, shprehje frazeologjike etj.);</li> <li>- përcakton tiparet e gjuhës së folur dhe e krahason atë me gjuhën e shkruar, si p.sh., struktura të thjeshta fjalish/struktura komplekse fjalish, informalitet/formalitet, përdoren pak referenca/përdoren shumë referenca etj.</li> </ul> <p><b>Diskutimi dhe bashkëveprimi në grup</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- mban një qëndrim të caktuar ndaj një diskutimi në grup;</li> <li>- luan rolin e moderatorit në një diskutim;</li> <li>- modifikon një pozicion në diskutime që realizohen në grupe të vogla ose të mëdha;</li> </ul>
--	---



	<ul style="list-style-type: none"> <li>- paraqet alternativën personale mbi çështjen ose tekstin e caktuar;</li> <li>- vlerëson përfundimet e një diskutimi;</li> <li>- merr nismën të ndryshojë rrjedhën e një diskutimi;</li> <li>- përdor përmbajtje të përshtatshme për qëllime, audienca, situata dhe kontekste të caktuara;</li> <li>- respekton kërkesën për një përmbajtje të ngjeshur duke marrë parasysh faktorin <i>kohë</i>;</li> <li>- parashtron argumentin përmes një përmbajtjeje të ngjeshur, duke respektuar faktorin <i>kohë</i>;</li> <li>- shpreh një mesazh koherent;</li> <li>- merr parasysh rolin e dëgjuesit, të qëllimit, të situatës dhe të kontekstit në një diskutim;</li> <li>- shfrytëzon pasurinë leksikore e semantike për të shprehur saktë mendimet e tij në diskutime në grupe të vogla e të mëdha.</li> </ul>
--	---

### Vlerat dhe qëndrimet

Nxënësi:

- komunikon në përputhje me normat shoqërore dhe me vlerat kulturore në situata të ndryshme;
- ndërmerr nisma dhe shpreh interesim për çështje të ndryshme;
- përdor imagjinatën dhe shpirtin krijues për zgjidhjen e problemeve;
- demonstroi vullnet dhe gatishmëri në detyrat individuale dhe në punët në grup;
- vlerëson punën në grup;
- respekton parimet, vlerat, bindjet dhe kulturën e të tjerëve;
- respekton trashëgiminë gjuhësore të popullit tonë;
- përdor dhe vlerëson gjuhën standarde shqipe dhe pasurinë leksikore të gjuhës shqipe;
- demonstroi vetëbesim, imagjinatë dhe shpirt krijues gjatë punëve të pavarura.

**Kompetenca:** Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

### Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi:

- reflekton ndaj informacionit të dëgjuar, rikujton përmbajtjen e informacionit, si dhe analizon mënyrën në të cilën stili dhe struktura e një fjalie ose e një ligjërate mbështetin qëllimin e saj;

- reflekton mbi informacione të llojeve dhe të fushave të ndryshme, si dhe përgjigjet në mënyrë të përshtatshme;
- demonstroi aftësitë e domosdoshme të të dëgjuarit kritik.

### Njohuritë

- Të dëgjuarit për të kuptuar.
- Të dëgjuarit kritik.
- Shkaqet kryesore të dëgjimit të dobët (mbingarkesa, mungesa e vëmendjes dhe shpërqendrimi, përqendrimi në detaje të parëndësishme etj.).
- Studime tekstesh të ndryshme që janë paracaktuar për t'u dëgjuar. Sugjerohet që nxënësit të dëgjojnë tekste nga burime të ndryshme, si p.sh.: DVD, internet, CD-ROM etj.

### Shkathtësitë

#### **Të dëgjuarit për të kuptuar dhe për të reflektuar**

##### Nxënësi:

- identifikon cilësitë e zërit (domethënë, ritmin, lartësinë, tonin dhe theksin) gjatë të dëgjuarit;
- identifikon fjalët dhe frazat kyçe në një tekst;
- dallon idenë kryesore;
- dallon detajet;
- parashikon (në lidhje me veprimin ose aktivitetin pasues) duke përdorur njohuritë e mëparshme (p.sh., njohuritë për temën ose konceptet e njohura), të dhënat kontekstuale (tema, pjesëmarrësit, pamjet) etj.;
- nxjerr përfundime në lidhje me qëllimin, temën, mesazhin etj.;
- harton pyetje të niveleve të ndryshme rreth tekstit;
- interpreton informacionin që merr nga burime të ndryshme;
- interpreton elementet zanore dhe pamore, të cilat rrisin kuptimin e teksteve;
- lidh atë që dëgjon me jetën reale dhe me përvojat personale;
- identifikon rendin e ngjarjeve ose të ideve;
- krahason informacionet e tekstit që dëgjon;
- kategorizon dhe klasifikon detajet;
- dallon shkakun nga pasoja;
- kupton idetë abstrakte kur përdoren shembuj konkretë;

#### **Të dëgjuarit për të vlerësuar**

##### Nxënësi:

- dallon faktin dhe opinionin;
- bën përgjithësime të thjeshta duke iu referuar ideve dhe çështjeve kryesore;

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- nxjerr përfundime nga idetë kryesore, detajet kyçe, shembujt specifikë, faktet kontekstuale etj.;</li> <li>- identifikon marrëdhënien problem-zgjidhje në një tekst;</li> <li>- dallon pikëpamjet e ndryshme në një tekst;</li> <li>- analizon elementet (fotografitë, animacionet, efektet zanore) e përdorura në tekst për të arritur qëllime të ndryshme;</li> <li>- analizon besueshmërinë e folësit, duke iu referuar qëllimit, ndjenjave, qëndrimeve, kualifikimit etj.;</li> <li>- identifikon përvojën e folësit;</li> <li>- vlerëson entuziazmin dhe pasionin e folësit për temën;</li> <li>- vlerëson rëndësinë dhe qëndrueshmërinë e argumenteve që jep folësi;</li> <li>- përcakton se si ndikon një tekst tek ai, si p.sh.: ngacmimi i shqisave (ngjyrat, lëvizjet, efektet zanore), përjetimi i emocioneve, pranimi ose jo i mesazhit;</li> <li>- analizon ndikimin (emocional apo racional) që ka teksti tek ai.</li> </ul>
--	---

### Vlerat dhe qëndrimet

Nxënësi:

- demonstroi vëmendje gjatë të dëgjuarit për një periudhë të konsiderueshme;
- shfaq ndjeshmëri dhe respekt ndaj folësit;
- reagon në mënyrë të përshtatshme duke treguar mirëkuptim ndaj folësit;
- ndërmerr nisma dhe shpreh interesim për çështje të ndryshme;
- demonstroi vullnet dhe gatishmëri në detyrat individuale dhe në punët në grup;
- respekton parimet, vlerat, bindjet dhe kulturën e të tjerëve;
- respekton trashëgiminë kulturore dhe artistike të popullit tonë;
- është i pavarur në vendimmarrje dhe në veprime;
- tregon kureshtje për të kërkuar dhe për të hulumtuar njohuri të reja.

**Kompetenca:** Të lexuarit e teksteve të ndryshme

**Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë**

Nxënësi:

- zbulon origjinën e fjalës për të kuptuar domethënien e teksteve, interpreton kuptimet e dyta si pasuri gjuhësore brenda tekstit, vlerëson kuptimet e figurshme të fjalëve, si dhe përdor materiale udhëzuese dhe hulumton fjalët e teksteve të ndryshme për të pasuruar fjalorin;
- përdor njohuritë dhe aftësitë e tij për të kuptuar dhe për të vlerësuar tekstin;
- përzgjedh burime të ndryshme informacioni, të përshtatshme për kërkime, përdor informacionin për të mbajtur qëndrim ndaj një çështjeje të caktuar, vlerëson dokumente publike për logjikën, argumentet, paraqitjen e shqetësimeve të audiencës dhe për mënyrën se si ia nxitin interesin lexuesit;
- krahason dy ose më shumë tekste që trajtojnë të njëjtat tema, për të treguar se si autorët nxjerrin përfundime të njëjta ose të ndryshme.

Njohuritë	Shkathtësitë
<p><b>Tekstet përshkruese</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Teknikat e shkrimit të tekstit përshkrues, si p.sh., përshkrim i një personi real ose i një personazhi apo personaliteti.</li> <li>- Karakteristikat strukturore, gjuhësore dhe stilistike të tekstit përshkrues.</li> </ul> <p><b>Tekstet rrëfyese</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Teknikat e shkrimit të tekstit rrëfyese, si p.sh., rrëfim i një ngjarjeje reale ose një artikull në një gazetë për një ngjarje.</li> <li>- Karakteristikat strukturore, gjuhësore dhe stilistike të tekstit rrëfyese.</li> </ul> <p><b>Tekstet udhëzuese</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Teknikat e shkrimit të tekstit udhëzues, si p.sh., një udhëzues për realizimin e një detyre të caktuar, ose një udhëzues se si përdoret një pajisje, një program etj.</li> <li>- Karakteristikat strukturore, gjuhësore dhe stilistike të teksteve udhëzuese.</li> </ul> <p><b>Tekstet argumentuese</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Teknikat e shkrimit të tekstit argumentues (një reklamë, një fjalim ose një ese etj.).</li> <li>- Karakteristikat strukturore, gjuhësore dhe stilistike të teksteve argumentuese.</li> </ul> <p><b>Tekstet informuese-paraqitëse</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Teknikat e shkrimit të tekstit informues-paraqitës, si p.sh., minutat e një takimi</li> </ul>	<p><b>Të kuptuarit e tekstit dhe reflektimi ndaj tij</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përdor njohuritë paraprake (p.sh., njohuri rreth temës, koncepte të njohura ose njohuri socio-kulturore) për të kuptuar tekstin;</li> <li>- shfrytëzon elemente, si: titulli, nëntitujt, organizimi i tekstit, fjalori etj., për të kuptuar tekstin;</li> <li>- bën parashikime duke u bazuar tek titulli, nëntitujt, fjalët kyçe etj.;</li> <li>- veçon idenë/idetë kryesore;</li> <li>- dallon shkakun nga pasoja, faktin nga opinioni (p.sh., dallon të dhënat e një studimi nga komentet personale);</li> <li>- kategorizon dhe klasifikon detajet e dhëna në tekst;</li> <li>- analizon modelet organizative të teksteve: renditje e ideve ose ngjarjeve, krahasim-kontrast, shkak-pasojë etj.;</li> <li>- nxjerr përfundime nga informacioni i tekstit, nga pikëpamjet e autorit etj.;</li> <li>- interpreton dhe integron informacionin e marrë nga një sërë burimesh (harta, grafikë, diagrame etj.);</li> <li>- harton pyetje të niveleve të ndryshme rreth tekstit;</li> <li>- formulon pyetje për të udhëhequr një kërkim ose një projekt;</li> </ul>

<p>(procesverbal), një CV ose një aplikim për punë etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Karakteristikat strukturore, gjuhësore dhe stilistike të teksteve informuese-paraqitëse.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- mbledh dhe vlerëson informacione në mënyrë të pavarur nga një sërë burimesh (p.sh., duke përdorur motorët e kërkimit, fjalët kyçe etj.);</li> <li>- parafrazon informacionin ose idetë e tekstit;</li> <li>- përmbledh idetë (nga një ose disa paragrafë);</li> <li>- identifikon qëllimin dhe audiencën (lexuesin) e tekstit;</li> <li>- identifikon dhe analizon elementet pamore (fotografi, ilustrime), të përdorura në tekstet e shkruara për të arritur qëllime të ndryshme;</li> <li>- bën përgjithësime në nivel kritik duke përdorur lidhjet brenda dhe jashtë teksteve;</li> <li>- vlerëson informacionin (besueshmërinë, saktësinë, mjaftueshmërinë, përdorimin e propagandës, ekzagjerimin, gabimin etj.);</li> <li>- bën lidhje mes një teksti dhe pikëpamjeve ose ideve të tjera jashtë tekstit, si dhe idetë e tekstit i zbaton në një situatë të re;</li> <li>- krahason lloje të ndryshme tekstesh (p.sh., një tekst rrëfyes letrar me një tekst rrëfyes joletrar), duke u bazuar në kritere të përgjithshme ose në të dhëna specifike;</li> <li>- dallon dhe krahason elemente të stilit në një shumëllojshmëri tekstesh;</li> <li>- demonstroi se si stili i autorit mund të ndikojë te lexuesi nëpërmjet zgjedhjes së fjalëve, teknikave të shkrimit, përdorimit të gjuhës së figurshme etj.</li> </ul> <p><b>Llojet e teksteve</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përcakton funksionet, llojin, qëllimet teknikat dhe karakteristikat gjuhësore, stilistike dhe strukturore të teksteve joletrare, si: <ul style="list-style-type: none"> <li>• teksti përshkrues,</li> <li>• teksti rrëfyes,</li> <li>• teksti udhëzues,</li> <li>• teksti argumentues,</li> </ul> </li> </ul>
--	---

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• teksti informues-paraqitës.</li> </ul> <p><b>Pasurimi i fjalorit</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përdor materiale udhëzuese (fjalorë, enciklopedi, internet etj.) që janë të përshtatshme për të pasuruar fjalorin në fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore;</li> <li>- përdor gjerësisht dhe me efikasitet dukuritë semantike, si: polisemia, homonimia, sinonimia, antonimia;</li> <li>- shfrytëzon përdorime të gjuhës së figurshme nga tekste të ndryshme;</li> <li>- dallon kuptimin e drejtpërdrejtë nga i nënkuptuari për të interpretuar forcën e fjalës.</li> </ul>
<p><b>Vlerat dhe qëndrimet</b></p>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- lexon për kënaqësi dhe për informacion;</li> <li>- ndan përvojat e tij të leximit me të tjerët;</li> <li>- respekton dhe pranon mendimin e të tjerëve në raport me lexime të ndryshme;</li> <li>- respekton etikën gjatë komunikimit personal dhe në grup;</li> <li>- vlerëson kontributin e të tjerëve gjatë kryerjes së një detyre;</li> <li>- vlerëson rëndësinë e leximit në jetën e njeriut;</li> <li>- shfaq tolerancë dhe respekt për kulturën dhe për gjuhën e tjetrit.</li> </ul>	

**Shënim.** Nxënësi, përgjatë vitit shkollor, lexon dhe shkruan, pothuajse, të njëjtat lloje tekstesh. Sugjerohet që shkrimi i tekstit të realizohet me nxënësit, pasi është lexuar dhe studiuar ai lloj teksti nga nxënësi.

<p><b>Kompetenca:</b> Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale</p>
<p><b>Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të shkruarit, përdor strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin e tij, vlerëson cilësinë e informacionit që gjen, si dhe reflekton ndaj shkrimit duke përcaktuar elementet për përmirësim;</li> <li>- përshtat shkrimin me qëllimet dhe lexuesit p.sh.,: të përshkruajë, të rrëfejë, të udhëzojë, të informojë, të argumentojë;</li> <li>- përzgjedh dhe organizon fakte, ide, opinione, jep shembuj dhe të dhëna për të realizuar një produkt shkrimi cilësor;</li> </ul>

- ushtrohet në veprimtari praktike dhe paraqet produkte të llojeve të ndryshme të shkrimit duke respektuar karakteristikat e tyre;
- përzgjedh leksikun e duhur dhe format gramatikore e strukturore gjatë të shkruarit, si dhe respekton rregullat drejtshkrimore.

### Njohuritë

*Punë me shkrim të detyrueshme gjatë klasës XII.*

- Përshkrimi i një personi të dashur ose i një personaliteti të njohur.
- Rrëfimi i një ngjarjeje reale ose shkrimi i një artikulli gazete për një ngjarje.
- Shkrimi i një udhëzuesi se si përdoret një pajisje ose një program.
- Shkrimi i një eseje argumentuese.
- Shkrimi i minutave të një takimi ose shkrimi i një aplikimi për punë.

*Shënim.* Mësuesi duhet ta ndjekë punën me shkrim në të gjitha fazat e saj.

Ndonjëherë nga punët me shkrim, nxënësit mund ta shkruajnë në kompjuter (në varësi të mundësive që ka shkolla). Për vlerësimin e disa punëve me shkrim mund të përdoret teknika e vlerësimit të nxënësit nga nxënësi. *Sugjerohet që kjo teknikë të përdoret në punët e mëposhtme:*

- Rrëfimi i një ngjarjeje reale ose shkrimi i një artikulli gazete për një ngjarje.
- Shkrimi i një udhëzuesi se si përdoret një pajisje ose një program.

Pjesa tjetër e punëve me shkrim duhet të vlerësohet nga mësuesi.

### Shkathësitë

#### Shkrimi si proces

Nxënësi:

- planifikon duke identifikuar qëllimin, lexuesin dhe kontekstin (që përcaktojnë regjistrin dhe tonin);
- krijon ose mbledh ide të përshtatshme për punët me shkrim duke përdorur strategji të ndryshme, si: shkrimi i lirë, stuhi mendimi, hartë koncepti, kllaster etj.;
- mbledh, vlerëson, zgjedh dhe sintetizon fakte dhe ide nga një shumëllojshmëri burimesh, të përshtatshme me qëllimin dhe nevojat e lexuesit;
- rishikon punët me shkrim për të përmirësuar strukturën, qartësinë dhe për të arritur saktësi në shprehjen e kuptimit;
- identifikon elementet e gjuhës dhe të përmbajtjes (fakte, ide, detaje etj.), të cilat janë të papërshtatshme për lexuesin dhe kontekstin, dhe i zëvendëson, shton, fshin ose riorganizon fjalë, fraza, fjali, fakte, ide, detaje përshkruese, emocionale etj.;
- përmirëson elementet tipografike dhe pamore, si p.sh.: madhësinë e shkronjave, hapësirën mes rreshtave, tipin e shkrimit etj.;
- përmirëson renditjen e fakteve, ideve dhe detajeve brenda ose në mes të paragrafëve;
- reflekton pas vërejtjeve të shokëve për punët e tij;
- korrigjon gabimet gjuhësore (gramatikë, drejtshkrim, pikësim);
- komenton dhe vlerëson punët e shokëve të klasës.

#### Shkrimi si produkt

Nxënësi:

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- organizon fakte dhe ide në përshtatje me qëllimin, lexuesin dhe llojin e tekstit (p.sh., përdor grafikë për paraqitjen efektive të informacionit);</li> <li>- mbështet mesazhin kryesor të një teksti me detaje, fakte dhe shembuj të përshtatshëm për qëllimin, lexuesin, kontekstin etj.;</li> <li>- i përmbahet temës së punës me shkrim;</li> <li>- përdor elemente të ndryshme të tekstit (titulli, titujt kryesorë, nëntitujt etj.) që janë të përshtatshme për lloje të ndryshme të teksteve;</li> <li>- shkruan tekste koherente;</li> <li>- përdor strategji mbështetëse (anekdota personale, mbështetje të besimet e përbashkëta, opinione ekspertësh) në mënyrë që të bindë lexuesin;</li> <li>- mbështet idetë dhe pikëpamjet në një tekst, duke integruar elemente pamore dhe zanore, të cilat rrisin qartësinë dhe ndikojnë të lexuesi;</li> <li>- shpreh ndjenjat dhe mendimet përmes shkrimit në tema që i përzgjedh vetë;</li> <li>- përdor një fjali të temës për të futur idenë kryesore në një paragraf;</li> <li>- përpunon dhe shtjellon idenë kryesore të një paragrafi duke përdorur shembuj, detaje, fakte, përshkrime etj.;</li> <li>- rimerr idenë kryesore në paragrafin përmbyllës të tekstit dhe shkruan mbylljen e tij;</li> <li>- ka stil dhe origjinalitet në punët me shkrim.</li> </ul> <p><b>Llojet e teksteve</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shkruan tekste përshkuese për qëllime dhe për lexues të ndryshëm (përshkrimi i një personi të dashur ose i një personaliteti të njohur);</li> <li>- shkruan tekste rrëfyese për qëllime dhe për lexues të ndryshëm (rrëfimi i një</li> </ul>
--	---



	<p>ngjarjeje reale ose shkrimi i një artikulli gazete për një ngjarje);</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shkruan tekste udhëzuese për qëllime dhe për lexues të ndryshëm (shkrimi i një udhëzuesi se si përdoret një pajisje ose një program);</li> <li>- shkruan tekste argumentuese për qëllime dhe për lexues të ndryshëm (shkrimi i një eseje argumentuese ose i një fjalimi);</li> <li>- shkruan tekste informuese/paraqitëse për qëllime dhe për lexues të ndryshëm (shkrimi i minutave të një takimi ose shkrimi i një aplikimi për punë).</li> </ul>
<b>Vlerat dhe qëndrimet</b>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të shkruarit;</li> <li>- demonstroi imagjinatë dhe shpirt krijues gjatë të shkruarit;</li> <li>- respekton gjuhën standarde dhe shmang fjalët e huaja gjatë të shkruarit (kur e kanë fjalën përgjegjëse në gjuhën shqipe);</li> <li>- vlerëson punët e të tjerëve;</li> <li>- bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre me shkrim.</li> </ul>	

<b>Kompetenca: Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit</b>	
<b>Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë</b>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zotëron njohuri gramatikore dhe leksikore që mundësojnë nivele të larta arritjeje në lexim-shkrim;</li> <li>- analizon ndryshimet mes gjuhës së folur dhe të shkruar; mes regjistrave formalë dhe joformalë, mes dialekteve e shtresave leksikore dhe gjuhës standarde;</li> <li>- vlerëson me argumente pasurinë leksikore të gjuhës shqipe;</li> <li>- kërkon materiale ose botime në biblioteka dhe në internet për të gjetur informacionin e nevojshëm për sistemin gjuhësor të shqipes;</li> <li>- vlerëson zbatimin e rregullave të drejtshkrimit dhe të pikësimit, si të domosdoshme në çdo profesion dhe veprimtari të jetës njerëzore.</li> </ul>	
<b>Njohuritë</b>	<b>Shkathtësitë</b>
<p><b>Morfologji dhe fjalëformim</b> (sugjerohen 5 orë)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Fjala dhe morfema.</li> <li>- Llojet e morfemave.</li> </ul>	<p><b>Morfologji</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- veçon tiparet e përbashkëta dhe të veçanta të fjalës dhe të morfemës;</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mënyrat e formimit të fjalëve: <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Prejardhja, kompozimi, përngjitja (rikujtim i shkurtër i njohurive të marra në vitet e mëparshme)</li> <li>➤ Nyjëzimi dhe konversioni.</li> </ul> </li> <li>- Mënyrat e përziera të formimit të fjalëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- dallon morfemat në një fjalë;</li> <li>- dallon morfemat fjalëformuese nga morfemat trajtëformuese;</li> <li>- përcakton mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe;</li> <li>- dallon dhe analizon një fjalë që është formuar me prejardhje;</li> <li>- dallon kur një fjalë është me prejardhje parashtesore, me prejardhje prapashtesore, me prejardhje parashtesore dhe prapashtesore dhe me prejardhje pa ndajshitesë, si dhe argumenton përgjigjen e tij;</li> <li>- formon fjalë të prejardhura (me parashtesë, me prapashtesë, me parashtesë dhe prapashtesë, pa ndajshitesë) me një temë të dhënë;</li> <li>- dallon fjalët e prejardhura (p.sh.: parathënie, prapaskenë, parashkollor etj.) nga fjalët që janë formuar me mënyrat e tjera të fjalëformimit;</li> <li>- dallon kur një fjalë është e përbërë dhe argumenton përgjigjen e tij;</li> <li>- formon fjalë të përbëra;</li> <li>- përcakton dallimet mes fjalëve të formuara me kompozim dhe fjalëve të formuara me mënyrat e tjera;</li> <li>- përcakton kur një kompozitë është këpujore dhe kur është përcaktore;</li> <li>- përcakton dallimet mes kompozitave këpujore dhe kompozitave përcaktore;</li> <li>- përcakton dallimet mes kompozitave të zakonshme dhe shkurtesave;</li> <li>- shkruan drejt shkurtesat;</li> <li>- dallon kur një fjalë është formuar me përngjitje dhe argumenton përgjigjen e tij;</li> <li>- formon fjalë të përngjitura;</li> <li>- dallon fjalët e përngjitura nga kompozitat;</li> <li>- dallon fjalët që janë formuar me nyjëzim;</li> <li>- përcakton se cilat pjesë të ligjëratës (klasa fjalësh) formohen me nyjëzim;</li> </ul>
--	--

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- dallon kur një fjalë është formuar me nyjëzim;</li> <li>- përcakton se cilat pjesë të pandryshueshme të ligjëratës formohen me konversion;</li> <li>- përcakton se cilat pjesë të ndryshueshme të ligjëratës formohen me konversion;</li> <li>- dallon fjalët që janë formuar me përngjitje dhe prapashtesim, me kompozim dhe prapashtesim, me nyjëzim dhe prapashtesim etj.;</li> <li>- formon fjalë të reja duke përdorur mënyrat e formimit të fjalëve;</li> <li>- vlerëson larminë e fjalëformimit të gjuhës shqipe.</li> </ul>
<p><b>Sintaksë</b> (sugjerohen 9 orë)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Fjalja e thjeshtë dhe fjalja e përbërë.</li> <li>- Fjalja e përbërë me bashkërenditje dhe fjalja e përbërë me nënrenditje.</li> <li>- Fjalitë e ndërmjetme.</li> <li>- Fjalitë e ndërkallura.</li> </ul>	<p><b>Sintaksë</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përcakton tiparet e fjalisë së thjeshtë dhe ato të fjalisë së përbërë;</li> <li>- analizon tiparet e përbashkëta dhe tiparet të veçanta mes fjalisë së thjeshtë dhe fjalisë së përbërë;</li> <li>- dallon marrëdhëniet kuptimore dhe lidhjet sintaksore që realizohen në fjalinë e thjeshtë dhe në fjalinë e përbërë;</li> <li>- dallon llojin e fjalive me bashkërenditje;</li> <li>- ndërton fjali të përbëra me bashkërenditje këpujore, kundërshtore, veçuese, përmbyllëse dhe shkakore-motivuese;</li> <li>- dallon llojet e fjalive të përbëra me nënrenditje;</li> <li>- ndërton fjali të përbëra me nënrenditje;</li> <li>- analizon fjalitë e përbëra me shumë pjesë;</li> <li>- veçon mjetet lidhëse (lidhëzat dhe fjalët lidhëse) në fjalitë e përbëra;</li> <li>- ndërton skemat e fjalive të përbëra me shumë pjesë;</li> <li>- ndërton një fjali të përbërë në bazë të një skeme të dhënë;</li> <li>- përshtat në kohë dhe në mënyrë foljet (kallëzuesit) në pjesët e fjalisë së përbërë;</li> <li>- përdor drejt shenjat e pikësimit të fjalitë e përbëra;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon fjalitë e ndërmjetme;</li> <li>- përcakton tiparet e përbashkëta dhe tiparet e veçanta mes fjalive të ndërmjetme dhe fjalëve ose togjeve të fjalëve;</li> <li>- ndërton fjali të ndërmjetme në mes, në krye dhe në fund të fjalisë, si dhe përdor drejt presjen;</li> <li>- përcakton tiparet e fjalive të ndërkallura;</li> <li>- analizon fjalitë e ndërkallura;</li> <li>- ndërton fjali të ndërkallura;</li> <li>- krahason fjalitë e ndërkallura me fjalitë e ndërmjetme;</li> <li>- përdor drejt shenjat e pikësimit në fjalitë e ndërkallura;</li> <li>- përcakton ligjërimet dhe stilet kur përdoren fjalitë e ndërkallura.</li> </ul>
<p><b>Leksikologji</b> (sugjerohen 7 orë)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligjërimet në gjuhën shqipe (ligjërimi i thjeshtë, ligjërimi bisedor dhe ligjërimi libror).</li> <li>- Stilet funksionale në gjuhën shqipe: stili i letërsisë artistike, stili politiko-shoqëror, stili shkencor-teknik, stili juridik- administrativ.</li> </ul>	<p><b>Leksikologji</b> Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përcakton llojet e ligjërimeve në gjuhën shqipe;</li> <li>- analizon tiparet e ligjërimet të thjeshtë, të ligjërimet bisedor dhe të ligjërimet libror;</li> <li>- krahason ligjërimin bisedor me ligjërimin e thjeshtë;</li> <li>- dallon llojin e ligjërimet në një tekst;</li> <li>- ndërton tekste të shkurtra të cilat kanë tiparet e ligjërimet të thjeshtë, të ligjërimet libror ose të ligjërimet libror;</li> <li>- përcakton kuptimin e termit “stil funksional”;</li> <li>- përcakton se cilit stil i përket një tekst;</li> <li>- analizon elementet kryesore të secilit stil;</li> <li>- krahason stilet me njëri-tjetrin;</li> <li>- harton tekste të shkurtra që u përkasin stileve të ndryshme (stili i letërsisë artistike, stili politiko-shoqëror, stili shkencor-teknik, stili juridik-administrativ).</li> </ul>
<p><b>Drejtshkrim dhe pikësim</b> (sugjerohen 6 orë)</p> <p><b>Shënim.</b> <i>Këto orë duhet të zhvillohen të integruara me njohuritë e mësipërme gramatikore.</i></p>	<p><b>Drejtshkrim dhe pikësim</b> Nxënësi:</p>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Drejtshkrimi i fjalëve me prejardhje të huaj.</li> <li>- Shkrimi i emrave të përveçëm të huaj.</li> <li>- Raste të përdorimit të nyjës <b>të</b> dhe jo <b>së</b>. Raste të përdorimit të nyjës <b>së</b> dhe jo <b>të</b>.</li> <li>- Përdorimi i presjes te fjalitë e përbëra dhe te fjalitë e ndërmjetme, si dhe i shenjave të tjera të pikësimit te fjalitë e ndërkallura.</li> <li>- Rregulla për shkrimin e bibliografisë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- shkruan drejt fjalët me prejardhje të huaj që kanë <b>-ia, -ie, -iu</b>, me <b>i</b> të theksuar në trup të tyre;</li> <li>- shkruan drejt fjalët me prejardhje të huaj me <b>-oo-</b>;</li> <li>- shkruan drejt fjalët nga latinishtja ose nga gjuhët romane, si dhe nga greqishtja, të cilat në gjuhën shqipe kanë një <b>c</b> të ndjekur nga zanorja <b>e</b> ose <b>i</b>;</li> <li>- shkruan drejt fjalët me burim nga greqishtja me <b>d</b> dhe <b>t</b>;</li> <li>- shkruan drejt fjalët me burim kryesisht nga greqishtja, latinishtja dhe nga gjuhët romane që në gjuhën shqipe kanë një <b>gj</b> të ndjekur nga një <b>e</b> ose <b>i</b>;</li> <li>- shkruan drejt fjalët e huaja nga greqishtja, latinishtja dhe gjuhët romane që kanë një <b>l</b> të thjeshtë ose dyfishe;</li> <li>- shkruan drejt emrat e përveçëm me prejardhje të huaj;</li> <li>- përdor drejt nyjën <b>të</b> dhe nyjën <b>së</b>;</li> <li>- tregon rastet kur duhet përdorur nyja <b>të</b> dhe kur duhet përdorur nyja <b>së</b>;</li> <li>- përdor drejt presjen të fjalitë e ndërmjetme dhe shenjat e pikësimit në fjalitë e ndërkallura;</li> <li>- u përmbahet rregullave të përcaktuara në shkrimin e bibliografisë;</li> <li>- përdor drejt shenjat e pikësimit dhe shkronjën e madhe në shkrimin e bibliografisë.</li> </ul>
--	--

**Vlerat dhe qëndrimet**

<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- vlerëson respektimin e rregullave gramatikore dhe drejtshkrimore, si dhe përdorimin e shenjave të pikësimit;</li> <li>- vlerëson pasurinë leksikore të gjuhës shqipe;</li> <li>- respekton shumëllojshmërinë gjuhësore mes njerëzve;</li> <li>- shfaq shpirt krijues dhe imagjinatë në përdorimin e gjuhës;</li> <li>- shmang fjalët e huaja të panevojshme gjatë komunikimit.</li> <li>- ndërmerr nisma në dobi të gjuhës shqipe;</li> <li>- bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre që ka lidhje me gjuhën.</li> </ul>
---

## 7. SQARIME PËR LLOJET E TEKSTEVE

Teksti është element i rëndësishëm i lëndës së gjuhës shqipe, pasi nëpërmjet tij nxënësit ndërtojnë dhe zhvillojnë kompetencat e lëndës dhe kompetencat kyçe. Teksti duhet të jetë në përputhje me zhvillimin emocional dhe intelektual të nxënësit. Vit pas viti, nxënësit njihen dhe studiojnë tekste, shkalla e vështirësisë së të cilave vjen duke u rritur. Kështu, p.sh., në klasën e dhjetë, nxënësit kanë marrë njohuri të përgjithshme për llojet e teksteve dhe për funksionet dhe qëllimet e tyre. Në klasën e njëmbëdhjetë dhe në klasën e dymbëdhjetë, njohuritë për tekstet vijnë duke u zgjeruar, si dhe shtohen njohuri të reja për karakteristikat ose veçoritë e llojeve të teksteve (p.sh., karakteristikat e një kronike - tekst rrëfyës).

Në lëndën e gjuhës shqipe, nxënësit demonstrojnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre në tekste të ndryshme. Teksti letrar studiohet në mënyrë të thelluar në lëndën e letërsisë, ndërsa në lëndën e gjuhës shqipe përmenden karakteristikat kryesore të teksteve dhe shërbejnë për të bërë krahasime mes llojeve të teksteve, si p.sh., krahasohet një përshkrim letrar dhe një përshkrim joletrar, ose një tregim me një rrëfim gojor.

Përgjatë tri viteve të arsimit të mesëm të lartë, nxënësit dëgjojnë, shkruajnë, lexojnë dhe flasin për lloje të ndryshme tekstesh. Kjo u jep mundësi atyre të kuptojnë (të dëgjojnë dhe të lexojnë) se si gjuha ndërton, formon, modelon përvoja nëpërmjet stilit, gjinive dhe kontekstit, si dhe të krijojnë përvojat e tyre nëpërmjet gjuhës.

Sugjerohet që çdo fragment ose tekst të punohet nga nxënësit, në afërsisht 3 orë mësimi.


## 8. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Programi i lëndës së gjuhës shqipe bazohet në parimin se të gjithë nxënësit kanë mundësi që të arrijnë rezultate të mira dhe të jenë të suksesshëm. Një nga çelësat kryesorë në suksesin e tyre është cilësia e mësimdhënies. Për një mësimdhënie cilësore, mësuesit duhet të respektojnë pikat e forta të nxënësve, të identifikojnë nevojat e tyre gjatë të nxënësve, të përcaktojnë saktë qëllimet e vlerësimit dhe të planifikojnë mirë orën e mësimin. Mësuesit duhet të informojnë nxënësit për rezultatet e të nxënësve, t'i ndihmojnë ata që të aktivizojnë njohuritë e mëparshme, të japin udhëzime të diferencuara sipas nevojave të tyre, t'i orientojnë kur punojnë në grupe, si dhe t'u mësojnë strategjitë e të nxënësve, në mënyrë që ata të ndërtojnë vetë njohuritë dhe dijet e tyre.

Metodat bashkëkohore të mësimdhënies i aftësojnë nxënësit të punojnë në grupe të vogla e të mëdha. Kjo lloj mësimdhënieje mundëson që nxënësit ta ndihmojnë njëri-tjetrin, si dhe krijojnë një mjedis të përshtatshëm për nxënësit që janë të tërhequr ose të druajtur. Studimet tregojnë se këta nxënës përparojnë më mirë në klasa që mbështetin ndërveprimin ose të nxënësve bashkëpunues. Pjesë përbërëse e mësimin duhet të jetë edhe ngulitja te nxënësit e cilësive, të tilla si: gatishmëria dhe vendosmëria për të çuar një detyrë deri në fund, komunikimi i qartë dhe brenda rregullave të mirësjelljes, shpirti i iniciativës, dëshira për të marrë përgjegjësi etj.

Gjuha shqipe mësohet më mirë nëpërmjet situatave në të cilat paraqiten ide, çështje dhe diskutime që janë të rëndësishme dhe me interes për nxënësit. Nuk mund të diktohen metoda ose aktivitete mësimore. Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin metoda, teknika dhe aktivitete që përkojnë me nivelin e nxënësve dhe që funksionojnë mirë në klasën e tyre. Megjithatë, mësuesit duhet të largohen nga mësimdhënia tradicionale. Praktikant mësimore bashkëkohore dëshmojnë se stimujt (shpjegimi i mësuesit) me të cilat ndeshen nxënësit, asnjëherë nuk janë të mjaftueshme për të përfutur njohuri dhe dije. Të nxënësve nuk është vetëm një dukuri stimul - përgjigje. Njeriu ka bërë gjithmonë përpjekje për të ndërtuar dhe për të rindërtuar kuptimin e dukurive nga jeta reale, për t'i bërë të kuptimshme ato. Në këtë mënyrë duhet të organizohet edhe procesi mësimor. Nxënësit duhet t'i ndërtojnë vetë njohuritë e tyre. Mësuesit duhet të krijojnë situata të nxënësve, në të cilat nxënësit ndërveprojnë me të tjerët dhe arrijnë të mësojnë duke bërë. Në këtë rast, ata e kanë më të lehtë edhe transferimin e këtyre njohurive ose shkathtësive në situata të reja dhe të panjohura më parë. Njëkohësisht, kjo filozofi e nxënësve i aftëson nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike dhe krijuese. Në diagramin e mëposhtëm është pasqyruar një situatë e thjeshtë të nxënësve, e cila “kontribuon” në zhvillimin e disa kompetencave kyçe dhe të kompetencave të lëndës, në lidhjen ndër-lëndore etj.

### Situatë të nxënësve



- **Puna me nxënësit me nevoja të veçanta, me vështirësi në të nxënë dhe me nxënësit e talentuar**

### *Nxënësit me nevoja të veçanta*

Organizimi i kurrikulës sipas kompetencave dhe me fokus integrimin i krijon mësuesit hapësirat për të përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të veçanta të nxënësit dhe për të personalizuar të nxënit e tyre. Mësuesi duhet të marrë parasysh faktin se nxënësit janë të



ndryshëm, kanë motivim, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. Në disa raste duhen bërë përshtatje të kurrikulës sipas diferencave të zhvillimit brenda një grup-moshe. Mësuesi mund të zgjerojë zhvillimin e kompetencave kyçe sipas nevojave individuale të nxënësve, për të zvogëluar dhe për të zhdukur diferencat brenda një shkalle të kurrikulës, në fund të saj.

### **Nxënësit me vështirësi në të nxënë**

Shumë nxënës me vështirësi në të nxënë arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënit njësoj si nxënësit e tjerë, nëse bëhen përshtatje në mënyrën e mësimdhënies dhe të vlerësimit të tyre.

Për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm të realizimit të kompetencës, mund të zhvillohen programe të veçanta, individuale, për nxënësit me nevoja të veçanta.

Për të përcaktuar se cilët janë nxënësit me nevoja të veçanta, ekziston një proces i bazuar në akte dhe rregullore të miratuara nga ministria. Nëpërmjet këtij procesi, prindërit, mësuesit dhe personeli tjetër mbështetës i shkollës identifikojnë nevojat e veçanta të një nxënësi, hartojnë një plan individual arsimor, që u adresohet këtyre nevojave, dhe rishikojnë progresin e nxënësit në përputhje me këtë plan.

Në rastin e nxënësve që formalisht janë përcaktuar si të veçantë, është veçanërisht e rëndësishme që stafi i shkollës, në bashkëpunim me prindërit, të mbështesë të nxënit e tyre. Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herë pas here me prindërit dhe me vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

### **Nxënësit me vështirësi në gjuhën shqipe**

Lëvizjet migratore dhe lëvizshmëria gjithmonë në rritje e individëve “sjellin” në shkollë nxënës që kanë vështirësi në gjuhën shqipe. Këta fëmijë e zotërojnë gjuhën shqipe në nivele të ndryshme. Atyre duhet t’u jepet mbështetje në formën e kohës shtesë, aq sa u nevojitet për të mësuar mirë gjuhën shqipe ose t’u ofrohen kurse formale nga shkolla përgjatë vitit mësimor ose gjatë pushimeve verore. Nëpërmjet kësaj pune të diferencuar, nxënësit me vështirësi në gjuhën shqipe mund të arrijnë rezultatet e të nxënit si të gjithë nxënësit e tjerë.

## 9. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Ai mat shkallën në të cilën kompetencat janë arritur nga nxënësi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj. Vlerësimi mbështetet tërësisht në rezultatet e të nxënësit të programit lëndor, ndaj mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato njohuri që nuk përshkruhen në program. Objektivi i vlerësimit janë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale, në përgjithësi, dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti. Mësuesi zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi.

**Disa nga mënyrat e vlerësimit në lëndën e gjuhës shqipe janë:**

- **Diskutimi mbi tema të ndryshme (gjithnjë e më komplekse).** Kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të kuptojë përmbajtjen dhe të zgjerojë informacionet e tij. Ajo bën të mundur që mësuesi të vlerësojë nxënësit për mënyrën se si diskutojnë dhe ndërveprojnë me të tjerët, si dhe për nivelin e zbatimit të njohurive në jetën e përditshme.
- **Prezantimi me gojë.** Kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin që të përzgjedhë dhe të sintetizojë materialet e ndryshme, të krijojë ose të mbajë qëndrim, si dhe të zhvillojë shkathtësitë e të folurit në publik.
- **Dëgjimi i një teksti.** Kjo mënyrë vlerësimi i ndihmon nxënësit të zhvillojnë shkathtësitë e tyre për të dëgjuar, për të kuptuar atë që dëgjojnë dhe për të gjykuar në mënyrë kritike.
- **Shkrimi i teksteve përshkruese, rrëfyese, udhëzuese, argumentuese dhe informuese-paraqitëse.** Kjo mënyrë vlerësimi i ndihmon nxënësit që të kërkojnë, të planifikojnë, të organizojnë dhe të redaktojnë shkrimet e tyre. Mësuesi vendos se për cilat prej këtyre shkrimeve (të paktën dy gjatë një viti) t'i vlerësojë të gjithë nxënësit. Për shkrimet e tjera, mësuesi duhet të vlerësojë grupe nxënësish. Në vlerësimin e shkrimeve, mësuesi duhet ta ndjekë nxënësin gjatë gjithë hapave të procesit të shkruarit dhe të vlerësojë se si nxënësi i zbaton ata. Procesi i të shkruarit është po aq i rëndësishëm sa produkti.
- **Leximet dhe studimet e teksteve të llojeve të ndryshme.** Kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të zhvillojë strategjitë e të lexuarit dhe të reflektojë ndaj tekstit. Gjithashtu, kjo mënyrë vlerësimi bën të mundur që mësuesi të vlerësojë strategjitë e të lexuarit që përdor nxënësi për të përfutur kuptimin e tekstit, si dhe aftësitë e tij për të analizuar, për të sintetizuar dhe për të gjykuar për tekstin.

- **Zhvillimi i një projekti.** Kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësit që të bashkëpunojnë me të tjerët, të hulumtojnë në burime të ndryshme informacioni, të lidhin njohuritë me jetën reale, si dhe të prezantojnë në mjedise publike.
- **Testimet.** Kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të përsërisë dhe të sintetizojë njohuritë lëndore. Mësuesi planifikon testime me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore që përbëhen nga një a disa kapituj.
- **Punimi i ushtrimeve.** Kjo mënyrë vlerësimi i ndihmon nxënësit të zbatojnë në praktikë njohuritë gjuhësore.
- **Portofoli i nxënësit.** Një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi është dhe koleksioni i punimeve të nxënësit përgjatë një periudhe kohore, për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë detyra me shkrim, projekte kurrikulare, ese të llojeve të ndryshme etj. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, ndërsa mësuesi rekomandon.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet e tij me gojë, me shkrim ose nëpërmjet veprimtarive a produkteve të tjera, si: shkruan, lexon, vlerëson, zbaton, analizon etj. Në punime të nxënësve me grupe, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësuesi nuk është i detyruar të vlerësojë me notë nxënësit në çdo orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara në orët e kaluara dhe rreth përmbushjes së detyrave jashtë klase. Herë pas here, mësuesi duhet të vlerësojë me notë duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

## 10. MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE

Për arritjen e kompetencave në lëndën e gjuhës shqipe është me rëndësi përdorimi i mjeteve dhe i materialeve mësimore, të cilat krijojnë mundësi që nxënësit të ndërtojnë dijet e tyre, t'i konkretizojnë njohuritë e tyre, të nxënë në mënyrë të pavarur, t'i përdorin dijet në jetën praktike dhe në kontekste të reja, të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik e krijues, të bashkëveprojnë me shokët e shoqet e klasës. Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë: tekstet shkollore, revistat, atlaset, enciklopeditë, antologjitë, televizori, projektori, videokasetat, kompjuteri, interneti, CD-të, DVD-të etj.